L I G J
Nr.7763, date 25.10.1993

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.7715, DATË 2.6.1993 "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.7501, DATË 19.7.1991 "PËR TOKËN"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të një grupi deputetësh

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Paragrafi i 14 i nenit 8 të ligjit nr.7715, datë 2.6.1993 ndryshohet si vijon:
- Vendimi i këshillit të komunës ose bashkisë është titull ekzekutiv i formës së prerë.

Neni 2

Pas paragrafit 14 të nenit 8 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
- Për ekzekutimin e vendimit të Këshillit të Komunës ose bashkisë sipas shkronjës "c" dhe "ç" kur kundravajtësi nuk e derdh vetë gjobën, ngarkohet zyra e përbarimit të gjykatës së rrethit, e cila brenda 15 ditëve të bëjë ekzekutimin e vendimit.

Neni 3

Paragrafi i parafundit i nenit 8 ndryshohet si vijon:
Kur kundravajtësi banon në juridiksionin e një rrethi tjetër, ngarkohet për ekzekutimin e vendimit ndaj kundravajtësit organi i përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji, i juridiksionit ku banon kundravajtësi.

Neni 4

Ministria e Drejtësisë detyrohet të shtojë përmbaruesit për çdo rreth sipas nevojave për ekzekutimin e këtyre vendimeve.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.685, datë 8.11.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.